

Për çdo parlament në botë ratifikimi i konventës 190 “Kundër dhunës dhe ngacmimit në ambientin e punës” është një vendim i mirë, por kur kjo konventë ratifikohet në parlamentin e Shqipërisë, përveçse është një vendim i mirë, është edhe një shpresë e mirë, sepse dhuna dhe ngacmimi në ambientin e punës ka qenë edhe së fundi mik i preferuar i disave të ulur në këtë sallë. E pamë më 8 janar se si virusi i prodhuar në laboratorin e selisë së Partisë Demokratike u përhap dhunshëm në atmosferën shqiptare dhe jo vetëm. Kur publiku të dëgjojë që ne po dedikojmë kohë dhe vendime kundër dhunës dhe ngacmimit, mbase do të ngjallet një shpresë e mirë, shpresa që politika e ulur në këtë sallë nuk do të jetë më protagoniste e kronikave të turpit të lajmeve nga bota. Jam edhe unë shpresëplotë se çdo karton që do të miratojë këtë konventë sot, do të ketë kuptuar përse dhuna dhe ngacmimi nuk duhet të jenë pjesë e mjedisit të politikës sonë, përse ato nuk duhet të kenë veto në tryezat tona dhe aq më pak të vendosin për Shqipërinë. Kjo konventë artikulon qartë një të drejtë, të drejtën për një mjedis pune të pastër nga dhuna dhe ngacmimi. E kam fjalën për të gjitha format që dhuna dhe ngacmimi mund të marrë, edhe për ato forma që përpiqen të kamuflohen nën terma të tillë si “mbledhje” apo “asamble”, sepse dhuna është fizike, është verbale, është psikologjike, por është njësoj e dëmshme dhe me pasoja gati të pariparueshme.

Pra, ta kuptojmë mirë sot se duke ngritur kartonin për këtë vendim kemi vendosur, gjithashtu, t’i hapim derën emancipimit të sjelljes sonë politike. Nëse nuk e kuptojmë, do të jetë keq për ne, do të jetë keq për ata që nuk e kuptojnë, por do të jetë keq edhe për ata që e kuptojnë, por që nuk e zbatojnë. Kjo konventë sanksionon edhe një herë se dhuna dhe ngacmimi ndalohen me ligj. Identifikimi i rasteve nuk i lihet më vullnetit të denoncueseve, por mjeteve efektive të hetimit dhe të dënimit. Natyrisht, mund të ndodhë që në ambiente pune mund të ketë përsëri fenomene të tilla, por kjo konventë siguron që, nëse këto fenomene ndodhin, ato do të trajtohen me ashpërsinë e duhur nga ligji, ndërsa viktimat nuk do të jenë të braktisura vetëm me fatin dhe forcën për t’u vetëngritur, por do t’u ofrohet asistencë qoftë social, qoftë juridike që ato të ringrihen. Të nderuar kolegë, Kur kemi hyrë në këtë sallë, i kemi vendosur vetes detyrë të respektojmë ne të parët vendimet që marrim dhe e kemi për detyrim të punës sonë krijimin e frymës, krijimin e frymës që motivon për keq apo krijimin e frymës që motivon për mirë; asaj që promovon dhunën dhe ngacmimin në ambientet e punës, apo asaj që promovon dialogun dhe shkëmbimin e ideve. Ky vit ka hyrë me shembujt e të dyja modeleve në politikën shqiptare. Përjetuam modelin e “bravës”, “shulit” dhe “qysqisë”, të turmës që linçon dikë aty apo kolegu që terrorizon kolegun në ambientin e punës, madje edhe kolege gra. Por po përjetojmë edhe modelin e anketës me qytetarin, mbledhjen e mendimit të lirë, debatit edhe me argumente kundër. Të dyja modelet janë të mundshme.

Të parin kjo konventë e ndalon dhe detyron ligjin të veprojë, por ne nuk duhet të bëhemi konsumatorët më të mëdhenj të policimit. Policinë duhet ta lëmë të okupohet më shumë me krimin se sa me sherrret për vula mes parlamentarëve, më shumë me pronarët që ngacmojnë punonjëset sesa me deputetët miq dhe armiq me shkopinj bejsbolli në duar. Ratifikimi i kësaj konvente është një lajm shumë i mirë, sepse nënkupton se zbatuesit e parë të saj do të jemi ne, deputetët që e miratojmë. Po e zbatuam ne, është e sigurt se më pak dhunë dhe ngacmim do të ketë në çdo qelizë të jetës në Shqipëri, qoftë familjare apo profesionale. Ratifikimi i kësaj konvente do të jetë një pengesë jo e parëndësishme ndaj promovimit të dhunës dhe ngacmimit, edhe kur ai kamuflohet në zërin e mekur të dikujt ulur këtu në sallë, që, në fakt, ky zë i mekur është tipik për ata që duan të të mbushin mendjen për diçka që nuk e besojnë as vetë. Zë i mekur, siç e thashë, kur përsërit shpesh refrenin: “Siç është

Partia Demokratike sot do të jetë Shqipëria nesër”. Në fakt, Shqipëria as në ditën e saj më të zezë nuk ka qenë dhe nuk do të jetë ndonjëherë aq e pashpresë, sa t’i duhet të zgjedhë një të ardhme ose me dikë që është i dëmshëm, ose me dikë që është i padobishëm. Siç është Partia Demokratike sot dhe si do të jetë Shqipëria nesër, janë si dy vija paralele, që do të thotë se nuk puqen në asnjë pikë. Faleminderit!